

SHTETI I NJU-JORKUT KA NEVOJË QË JU TË PËRFSHIHENI!



Çfarë është censusi?

Censusi numëron çdo person që jeton në Shtetet e Bashkuara.

Ai mbahet vetëm çdo dhjetë vjet.



Censusi vendos:



Qindra miliarda nga fondet federale për arsimin publik, kujdesin shëndetësor, strehimin e përballueshëm, infrastrukturën dhe të tjera.



Numrin e përfaqësuesve që ka qyteti i Nju-Jorkut në Kongres.



Se si të marrim vendime të rëndësishme për politikat vendore, shërbimet e urgjencës, transportin, kujdesin shëndetësor, dhe të tjera, bazuar mbi të dhëna të sakta.

CENSUSI NDIKON NË NDARJEN E BARABARTË TË QINDRA MILIARDAVE PËR:



Programin e Sigurimeve për Shëndetin e Fëmijëve (Children's Health Insurance Program, CHIP), arsimin, mësuesit, pajisjet, programet pas shkollës, duke përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta dhe ato familje me të ardhura të pakta.



Arsimin për të rriturit, programet e trajnimit për punë, duke përfshirë shërbimet për veteranët, të lindurit jashtë, personat me aftësi të kufizuara, si dhe njujorkezët me precedentë penalë.



Përmirësimin dhe programimin e qendrave për të moshuarit, duke përfshirë vaktet.



Ndihmën për strehim të përballueshëm (Seksioni 8), mirëmbajtje, riparime dhe përmirësime.

Prandaj ne duam që të gjithë njujorkezët të përfshihen.

Kur ju i përgjigjeni censussit, ju i jepni formë të ardhmes së komunitetit tuaj.

Në vitin 2010, vetëm **62%** e njujorkezëve iu përgjigjën censussit, shumë më pak se **76%** e mesatares kombëtare.

Nëse më shumë njujorkezë përgjigjen në vitin 2020, ne do të shikojmë më shumë para që derdhen për shkollat tona, për kujdesin shëndetësor, dhe për programet dhe shërbimet nga të cilat varemi çdo ditë.



Çfarë kërkohet për censusin?

- ✓ Sa persona jetojnë ose qëndrojnë në shtëpinë tuaj
- ✓ Gjinia, moshë, raca dhe përkatësia etnike e tyre
- ✓ Nëse jeni pronar i shtëpisë suaj apo jetoni me qira
- ✓ Adresa e shtëpisë suaj



Censusi 2020 nuk ju pyet për:

- ✗ Statusin e emigracionit apo shtetësisë
- ✗ Të ardhurat
- ✗ Numrin e sigurimeve shoqërore

Informacioni juaj është i sigurt!

- 🔒 Të gjitha përgjigjet janë konfidenciale, të mbrojtura me ligj dhe nuk do të përdoren kundër jush në mënyrë.
- 🔒 Me ligj, Zyra e Censurit nuk mund të ndajë asnjë informacion personal me agjencitë e tjera qeveritare, duke përfshirë edhe organet ligjzbatuese.



Dënimet për shkeljen e ligjit përfshijnë deri në pesë vjet burgim dhe gjoba deri në 250 000 \$.

Si po përgatitet qyteti i Nju-Jorkut për censusin.

Në vitin 2019, Administrata de Blasio prezantoi Censusin 2020 të NYC-së, një nismë organizative unike në llojin e saj për të garantuar një numërim të plotë dhe të saktë të të gjithë njujorkezëve në Censusin 2020. Ky program përfshin:

- ➔ Fondi i qytetit të Nju-Jorkut për një numërim të plotë, i mbështetur nga Administrata de Blasio dhe financimi i Këshillit të Qytetit, investoi 19 milionë \$ për edukimin dhe mobilizimin e censusit përmes organizatave komunitare që njujorkezët njohin dhe besojnë.
- ➔ Agjencitë partnere që do të kenë qasje në fuqinë punëtore prej 350 000 punëtorësh të qytetit dhe institucionet kryesore të qytetit, duke përfshirë bibliotekat, spitalet, institucionet fetare, kulturore dhe të arsimit të lartë.
- ➔ Një fushatë marketingu në terren e drejtuar nga qyteti për të mbërritur te çdo njujorkez. Bëhuni vullnetar në lagjen tuaj: nyc.gov/census

Kur fillon censusi?

MË 12 MARS 2020

my2020census.gov




Për herë të parë, ju do të mund të plotësoni censusin në internet, me email, ose me telefon, në gjuhë të ndryshme.



Kontrolloni kutinë tuaj postare për informacione nga Zyra e Censurit në lidhje me mënyrën e plotësimit të formularit.



Çdo degë e bibliotekës publike të Nju-Jorkut dhe shumë organizata të besuara komunitare do të ofrojnë edhe ndihmë në plotësimin e formularit.



Mëso më shumë:

nyc.gov/census